


## Manuali i aplikacionit online për shtyerje të përkohshme të pagesës së kësteve kreditore për individë

Qëllimi i këtij manuali është të informoheni për përdorimin e platformës online për të aplikuar për shtyerje të përkohshme të pagesës së kësteve kreditore për individë. Në këtë manual mund të gjeni një shembull se si duhet të plotësohet kërkesa në fjalë.

\* Të gjitha fushat janë të obliguara të plotësohen

Për çdo pyetje eventuale gjatë përdorimit të platformës së shtyarjes së përkohshme të pagesës së kësteve kreditore, ju lutem na kontaktoni Qendrën e Thirrjeve në numrin 038 500 500 ose 049 73 33 22.

Për tu qasur në aplikacionin online për pezullim të përkohshëm të kredive, ju duhet të hapni web faqën zyrtare të Bankës Ekonomike [www.bekonomike.com](http://www.bekonomike.com) dhe të klikoni aplikacionin si më poshtë:



The screenshot shows the Banka Ekonomike website interface. At the top, there is a navigation bar with the bank's logo, contact number (+383(0) 38 500 500), a search bar, and a login field labeled 'Kyçu: e banking'. Below the navigation bar, there are menu items: Fillimi, Per Banken, Individët, Bizneset, Kujdesi ndaj Klientëve, and Burimet Njerezore.

The main content area features a large banner for 'KREDI INDIVIDUALE deri në 35,000€' with the text 'PA HIPOTEKË AFATI DERI NË 15 VJET'. To the right of the banner is a photo of a smiling couple sitting on a sofa, with the text 'KREJT BOHEN!' above them.

Below the banner, there is a section titled 'Shërbimet Elektronike' with four icons: E - Banking, SMS - Banking, Flexi Kartela, and SMS Mbushja. To the right of this section, there are three red callout boxes with white text and arrows pointing to specific application buttons:

- Top callout: 'Aplikimi online për shtyerje të pagesës së kreditë për individë' (with a red border)
- Bottom-left callout: 'Aplikimi online për shtyerje të pagesës së kreditë për individë' (circled in red)
- Bottom-right callout: 'Aplikimi online për shtyerje të pagesës së kreditë për biznese' (with a red border)

At the bottom of the page, there are sections for 'Lajmet' and 'Shpalljet', with a notice 'NJOFTIM PER ORAR TE RI TE' below them.

**1. Pasi të keni hapur aplikacionin në fjalë duhet të plotësohen të gjitha fushat si shembulli ne vijim.**

**2. Shëno emrin.**

*Emri:*

Filan

**3. Shëno mbiemrin.**

*Mbiemri:*

Fisteku

**4. Shëno numrin personal 10 shifror.**

*Numri personal:*

123456789

**5. Shëno qytetin dhe adresën e banimit.**

*Qyteti, Adresa e banimit:*

Prishtine, Sheshi Nena Tereze Pn

**6. Shëno numrin e telefonit 044/045/046/049/123456.**

*Numri i telefonit:*

044123456

**7. Shëno email adresën**

*E-mail adresa:*

filanfisteku@gmail.com

**8. Shëno numrin e llogarisë në Bankën Ekonomike i cili fillon me 14.**

*Nr. i llogarisë në Bankën Ekonomike:*

1401123456789123

**9. Përzgjedhni nga lista rrëshqitëse vendin ku jeni punësuar.**

*Vendi ku jeni i punësuar/punëdhënësi:*

Kompani private ▼

**10. Shëno emrin e punëdhënësit.**

*Shëno emrin e punëdhënësit:*

Restaurant 1234

**11. Përzgjedhni nga lista rrëshqitëse Degën/Nëndegën ku ju është lejuar kredia.**

*Dega ku është lejuar kredia:*

Dega Prishtinë - Qafa ▼

**12. Shkruani arsyen e vështirësisë së pagesës.**

*Ju lutëm e shkruani arsyen lidhur me kërkesën për shtyerje të pagesës. (vonesë në pagë, ulje e pagës, ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit dhe periudhën kur është ndërprerë kontrata, të tjera):*

Duke ju referuar masave të Qeverisë së Kosovës që kanë vendosur të mbyllin veprimtaritë gastronomike, si kafiterite, restorantet etj, në restorantin në të cilin jam duke punuar nuk do të na paguhet pagat e muajit mars, andaj kërkoj nga ju që të shqyrtoni kërkesën time, për shtyerje të produkteve kreditore.

**13. Nga lista rrëshqitëse zgjedh llojin e produktit për të cilin dëshironi të bëni shtyerjen e kështit.**

*Lloji i produktit 1:*

Kredi ▼

**14. Shëno shumën e lejuar të produktit të përzgjedhur.**

*Shuma e lejuar e produktit 1:*

4000

**15. Nga lista rrëshqitëse zgjedh llojin e produktit të dytë për të cilin dëshironi të bëni shtyerjen e këstit. Në rast se nuk keni produkt tjetër kreditor, apo nuk dëshironi të bëni shtyerjen e produktit të dytë, atëherë tek lista rrëshqitëse përzgjedhni opsionin “nuk kam”.**

*Lloji i produktit 2:*

Mbitërheqje ▼

**16. Shëno shumën e lejuar të produktit të përzgjedhur.**

*Shuma e lejuar e produktit 2:*

300

**17. Nga lista rrëshqitëse zgjedh llojin e produktit të tretë për të cilin dëshironi të bëni shtyerjen e këstit. Në rast se nuk keni produkt tjetër kreditor, apo nuk dëshironi të bëni shtyerjen e produktit të tretë, atëherë tek lista rrëshqitëse përzgjedhni opsionin “nuk kam”.**

*Lloji i produktit 3:*

Nuk kam ▼

**18. Dhe në fund, pasi të keni klikuar me tick ✓, duhet të klikoni butonin Dërgo dhe kërkesa juaj do të dërgohet.**

- Duke proceduar me këtë kërkesë për shtyerje të afatit të pagesave për marrëveshjet kreditore të shënuara në këtë aplikacion, unë deklaroj dhe garantoj se informacioni i dhënë si më lartë është i vërtetë dhe i saktë. Po ashtu, deklaroj se jam i vetëdijshëm për pasojat në rast se, informatat e lartëcekura nga ana ime nuk janë të vërteta apo të sakta, të cilat do të mund të vërtetohen nga ana e Bankës duke kërkuar dokumente mbështetëse, të cilat pasoja përfshijnë por nuk kufizohen në: refuzimin e këtij aplikacioni për shtyerje të afatit të pagesës së borxhit, kthimin në gjendjen e mëparshme në rast se kërkesa për shtyerje aprovohet, sipas kushteve kontraktuale në marrëveshjet e produkteve kreditore, si dhe ndërmarrjen e të gjitha veprimeve ligjore nga ana e Bankës. Gjithashtu jap pëlqimin Bankës për përdorimin e të dhënave të mija personale vetëm sa i përket të drejtës së kësaj kërkesë të parashtruar nga ana ime.*

*Shenim/Note: Banka do të ju dergon planin e ri të pagesës, nëse ju aprovohet kërkesa për shtyerje të obligimit tuaj ndaj bankës, përmes formës elektronike dhe ju e konfirmoni përmes email-t tuaj zyrtar të drejtën e ndryshimit të planit të pagesave.*

Dërgo